

NEWSLETTER

SINDIKATA E PUNONJESVE TE POST - TELEKOMIT SHQIPTAR



3800 punonjës të
Teleperformance
Albania me
kontratë kolektive!



Sfidat e të
ardhmes!
Cfarë pritet të
ndodhë?



INFLACIONI PO MBYT !

Tre mujori i dytë i vitit 2022 shënoj rritjen më të lartë të inflacionit në vlerën **6.7 %** (INSTAT) duke i futur punonjësit në një situatë akoma më të rëndë financiare.

Mos indeksimi i pagave çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit, i cili është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, ka bërë që pagat e punonjësve në të gjithë sektorët të zhvleresohen çdo vit. Sot punonjësit Shqiptar punojnë njësoj por paguhen më pak. Me rritjen e çmimeve punonjësit që marrin paga mesatare po hasin vështirësi të mëdha me financat e tyre. Sigurisht që pozicionet e larta drejtuese të kompanive nuk po arrijnë të kuptojnë rëndësinë që ka indeksimi i pagave për punonjësit e tjerë. Sindikata e Poste-Telekomit e ka pasur gjithmonë në kërkesat e saj inflacionin duke e përfshirë si në kontratat kolektive por dhe në kërkesat e saj të përsëritura.

SPPTSH i ka drejtuar kërkesë me shkrim të tre kompanive me të cilat ka të firmosur dhe kontratën kolektive, Altelecom, Makhes, Teleperformance duke kërkuar që të merret menjëherë një vendim për



indeksimin e pagave të punonjësve duke marr për bazë indeksin e inflacionit të publikuar nga INSTAT. Këto shkresa zyrtare gjithashtu janë shoqëruar dhe me kërkesa të tjera specifike për cdo kompani. Për punonjësit në kompaninë Altelecom është kërkuar shpërblimi i performancës, për punonjësit e Makhes është përsëritur kërkesa për ditën e Diele që të jetë pushim për të gjithë teknikët ndërsa për Teleperformancë është kërkuar vendimi për rritjen e pagave të punonjësve të Durrësit.

Sindikata ka kërkuar që kërkesat të trajtohen me prioritet për të gjetur një zgjidhje sa më të mirë në favor të palëve, pasi mos trajtimi i tyre, do të rris pakënaqesinë e punonjësve dhe do të ul cilësinë e punës duke e detyruar sindikatën të përshkallëzoj këto kërkesa me forma të tjera ligjore



A ka dritë në fund të tunelit ?

2 vite pandemi shkaktuan probleme me shëndetin por dhe humbje jete të punëtorëve në çdo sektor. Sot më shumë se kurrë protestat e Cikagos të 1 MAJ 1886 për 8 orarëshin e punës, nga ku ka zanafillën kjo ditë, ku 200,000 mijë punonjës u hodhën në grevë dhe 8 prej tyre humbën jetën në përpjekje për të fituar të drejtat merr kuptim te plote.

“Maji i punëtorëve” i gjeti punetoret shqiptar shume larg asaj qe duhet te ishte bere per ta keto 32 vite demokraci. Sot fatkeqesisht punetoret si ne sektorin privat ashtu dhe ne ate publik nuk vlersohen ne menyren e duhur, sot vazhdojme te kemi me dhjetra te vdekur ne vendet e punes dhe nje perdorim te forces te punedhenesit per te mos lejuar organizimin sindikal dhe per mos degjuar zerin e punetoreve. Ashtu si ne Cikago ku koha tregoi se punëdhënësit do të përdornin arsenalin e tyre, që nga gjykatat, deri te policia ashtu dhe sot ne Shqiperi vazhdojme te jemi si 137 vite me para. Punedhenesit si ne privat dhe publik jane duke i perdorur te gjitha armet e tyre. Prandaj eshte koha mos te rrim duarkryq por te kerkojme me shume te drejta per te permiresuar jetet dhe atdheun tone.

Dikush do te thote shume gjera jane bere, sigurisht qe gjera te mira jane bere por sot realiteti flet ndryshe. Fuqi punetore qe largohet cdo dite. Shifrat e te larguareve jane 3 fishuar. Njerez qe po humbin shpresat se ky vend po permiresohet. Ky vend jo vetem nuk po permiresohet po fatkeqesishte dramet sociale po thellohen. Qeveria duhet te kuptoj qe duhet ndryshuar filozofia e qasjes ndaj problemeve sociale dhe atyre te punes


Rritja e mireqenies sociale te te gjithë punetoreve duhet te jete objektivi kryesor. Kjo do te ndalonte ikjen e njerezve nga Shqiperia. SPPTSH do te vazhdoj te shpalos platformen e saj

“ME NE TE PARET” e cila do ti detikohet luftes sone per te permiresuar mireqenien e punonjesve brenda sektorit, rritjen e sigurise per vendet e punes dhe permiresimin e klimes se botes se punes ne te gjithë aspektet anembane Shqiperise. Parimi jone eshte dhe mbetet i thjesht te behemi bashke per te ndihmuar njeri tjetrin. “Me Ne Te Paret, Me Punetoret Te Paret”. Disa nga pikat qe S.P.P.T.SH. kerkon jane :

1. Indeksimi i inflacionit ne paga te jete i detyrueshem per te gjithë punedhenesit si ne sektorin publik dhe privat. Indeksimi te aplikohet edhe mbi pagen minimale cdo vit.
2. Rritjen e Pages Minimale ne 40,000 leke dhe hartimin e nje plani per rritjen e saj cdo vit.
3. Rikthimin e pages se 13 per te gjithë sektoret publik dhe privat si nje detyrim ligjor.
4. Kontrata kolektive sektoriale te cilat ju japin punonjesve dhe aty ku ska sindikata me shume te drejta dhe perfitime.
5. Ulja oreve javore te punes nga 40 ore ne 35 ore, pa ndikuar ne pagat aktuale.
6. Rritja e diteve te lejeve vjetore ne baze te moshes dhe vjeteresise ne pune.
7. Ulja e pabarazise se te ardhurave midis pozicioneve drejtuese dhe punetoreve.
8. Nxitja e organizimit kolektiv ne sindikata si ne sektorin publik ashtu dhe ate privat.

Ne vazhdim ne do te shpalosim dhe pikat e tjera te cilat duhet te degjohen dhe merren seriozisht nese vertet duam qe te gjithë te ndihmojme per permiresimin e klimes se punes. **“Do të vijë një kohë kur heshtja jonë do të jetë më e fuqishme, se zëri që ju po mbytni sot”.** Ishin këto fjalët e fundit të një nga katër punëtorët e pafajshëm, që u ekzekutuan pas shpërthimit të një bombe në Çikago, në maj të vitit 1886, ku humbën jetën tetë drejtuesit kryesorë të lëvizjes së punëtorëve.

S.P.P.T.SH ju ben thirrje të gjithëve të solidarizohen dhe te organizohen ne sindikata ne menyre qe ta fitojm kete lufte per veten tone dhe per te gjithë Shqiptaret.



Kendi Poetik

Poezi e botur me 1901 nga Faik Konica

O të humbur shqipëtar
Seç qenkeni për të qarë!
Për të qar' e për të sharë,
Për të shar' e për të vrarë!
Armiqtë mbë dhé ju hodhnë,
Dhe ju shtypnë sa u lodhnë!
Sa u lodhn' e sa ju ngopnë
Ju gdhendnë edhe ju rropnë.
As bukë, as brekë s'ju lanë,
Ju punoni, ata hanë!
Nuk ju lan' as pakë nderë
Q'e kini pasur përherë.
As nder, as turp, as gjak s'kini
Unji kryet dhe po rrini.
I duroni vet armiqtë;
Prisni vdekjen apo vdiqtë?
Shërbëtorë t'Anadollit,
Kleçk e lodra të Stambollit.
Në mos u shove fare,
Ndizu, zemra shqipëtare!
O shqipëtarë barkzbrazur,
Fustançjerr' e këmbëzbathur
Zemërohuni një herë,
Mprehni kordhët për të prerë,
Mprehni kordh' e mprehni pallë
Të ju ndritin yj mi ballë,
Ti frikësoni zuzarët
Ç'i shuan shqipëtarët,
E në vend tuaj të rroni
Si të doni e si të thoni

SFIDAT E TE ARDHMES!

Më kërkesë të Sindikatës, është zhvilluar një takim miqësor prezantimi midis përfaqësuesit të 4iG në Shqipëri z. Robert Budafoki dhe kryetarit të Sindikatës së Punonjësve të Poste-Telekomit Shqiptar z. Renato Mucaj.

z. Budafoki është informuar mbi aktivitetin e sindikatës dhe i janë bërë prezent disa shqetësime dhe kërkesa që aktualisht punonjësit kanë në Altelecom. Dy pikat kryesore të cilat Sindikata ngriti edhe në këtë takim janë Indeksi i pagave dhe pagesa e Performance Bonusit çështje të cilat u morën në konsideratë për tu diskutuar me tej dhe me drejtuesit e kompanisë.

- Gjithashtu gjatë këtij takimi është kërkuar informacion edhe në lidhje me bashkimin e të dy kompanive dhe planeve të 4iG mbi këtë çështje? Ku na është sqaruar se kompanite pritet të bashkohen deri në fillimin e vitit



tjetër dhe ky proces pritet të nis në Shtator të këtij viti! Duke qenë që ky proces pritet të shoqërohet edhe me shkurtime të vëndeve të punës Sindikata ka kërkuar që ky proces të jetë sa më transparent, punonjësve tju jepet mundësia për tu integruar dhe sipas legjislacionit në fuqi. Sindikata ka kërkuar të jetë e informuar mbi procesin dhe të jetë pjesë vendimmarrjeve që kanë të bëjnë me vendet e punës. Përfaqësuesi i 4iG u zotua që dhe nga ana e tyre do të ndiqet një procedurë sa më transparente që do të fillojë si fillim me informimin e punonjësve.

Delegacioni Sindikates Gjermane Ver.Di në SPPTSH

Patëm kënaqësinë të mirëprisnim në zyrat e SPPTSH-së, delegacionin e sindikatës gjermane Ver.di z. Ado Wilhelm dhe znj. Steff Schulze të cilët shoqëroheshin nga drejtuesja e fondacionit gjerman FES znj. Stine Klapper, z. Genci Lamllari dhe z. Enea Protopapa. Gjatë këtij takimi u diskutua për punën e sindikatës me rrjetet sociale, sistemet që përdoren nga sindikata dhe platformat e tjera teknologjike që mund të përdoren për punën e sindikatës. Gjatë takimit përfaqësuesit e Sindikatës Poste Telekomit Shqiptar, i shpjeguan me detaje punën e sindikatës me platformat e rrjeteve sociale dhe zhvillimet e fundit në sindikatë. Ky takim i parapriu trajnimit që u mbajt në Tiranë me temë "Puna e sindikates me ndihmen e rrjeteve sociale" ditën e shtunë, 2 prill 2022!



3800 PUNONJES

te Teleperformance
Albania me kontrate
kolektive!



SPPTSH SHKRUAN NJE HISTORI SUKSESI

Mbas një pune të gjatë 14 mujore është arritur firmosja e kontratës kolektive për rreth **3800** punonjës të kompanisë Teleperformance të cilët do të kenë një zë zyrtar përfaqësimi dhe një kontratë kolektive që do tju mundësojë kushte më të mira pune dhe benefite financiare. Gjatë negociatave SPPTSH ka punuar dhe është mundur për të arritur të gjitha kërkesat e punonjësve.

Ndër më kryesoret ishin rritja e pagave, vecanërisht rritja e nivelit minimal të pagave për punonjësit e Durrësit.

Sindikata jonë ka punuar me kembengulje dhe nje kohe te gjate per plotesimin e kerkesave te operatoreve. Pavarësisht vështirësive të hasura gjatë negociatave, më në fund kemi arritur që të sigurojmë për punonjësit nga kontrata kolektive:

Paga minimale orare për operatorët nga 220 lekë/neto DO TE RRITET gradualisht si vijon:

PAGA MINIMALE ORARE NGA 220 LEKE

- Përgjatë vitit 2022 paga minimale = 250 lekë/orë neto.
- Përgjatë vitit 2023 paga minimale = 280 lekë/orë neto.
- Përgjatë vitit 2024 paga minimale = 310 lekë/orë neto.
- Punëdhënësi do të rrisë pagën minimale për operatorët edhe mbi këto nivele në varësi të vjetërsisë së tyre në punë.



- Punëdhënësi çdo muaj Gusht të vitit pasardhës do të hyj në bisedime me sindikatën për **rishikimin e nivelit të pagave** duke marrë për bazë **inflacionin** dhe rrethana të tjera.
- Punëdhënësi do të jap një **shperblim** prej **6.000** (gjashtëmije) Lekë, në fund te çdo viti kalendarik, për punonjësit që kanë plotësuar 2 vjet vjetërsi në punë.
- Në varësi të vjetërsisë në punë, lejes vjetore do ti shtohen ditët :
- 2- 5 vite pune = 1 dite pushim
- Mbi 5 vite pune = 2 dite pushim
- Për përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve pasuniversitar si dhe trainimeve të ndryshme në lidhje me profesionin që ushtron - **5 dite** pushim të paguar në vit.
- Punëdhënësi i jep shperblim Punëmarrësit **1 page** mujore ne rast vdekje te vete Punemarresit.
- Punëdhënësi jep shperblim deri në masën prej **2 pagash** në rast vdekje te Punëmarrësit në punë.
- Punëdhënësi i jep shperblim Punëmarrësit **1 (nje) page** mujore me rastin e daljes në pension.

Së bashku jemi më të fortë